



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJISE**

VENDIM

Nr. 127 Datë 30.08.2012

MBI

**KËRKESËN E GSA SH.P.K DHE “RUDNAP ENERGY TIRANA” SHPK
MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.114 DATE 22.08.2012**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma “ç”, paragrafi “ii”, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 7, gërma “b”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe Kapitullit X, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.08.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë GSA sh.p.k me nr. 29082012 Prot, datë 29.08.2012 dhe “RUDNAP ENERGY TIRANA” sh.p.k mbi zbatimin e vendimit të ERE nr. 114, date 22.08.2012, si dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Duke konsideruar se:

Vendimi nr.114, date 22.08.2012, përcaktonte alokimin e kapaciteteve disponibël të interkonjeksionit për muajin shtator 2012 Shoqërisë CEZ Shpërndarje Sh.a për sasinë 155 MW, për mbulimin e humbjeve të ndara sipas kufirit dhe periudhave të përcaktuara nga OST sh.a si dhe Klientëve të kualifikuar për sasinë 45 MW, të ndara proporcionalisht sipas kufirit dhe periudhave të përcaktuara nga OST Sh.a me kusht CEZ Shpërndarje sh.a dhe Furnizuesit e Kualifikuar të bëjnë nominimet dhe pagesat për kapacitetet e interkonjeksionit.

Ne datën 29.08.2012, në kushtet e moszbatimit nga Cez Shpërndarje të detyrimit sipas pikës 3, të Vendimit nr. 114, date 22.08.2012, OST zhvilloi ankandin për alokimin e kapaciteteve të akorduara sipas pikës 1 të këtij vendimi shoqërisë Cez Shpërndarje.

Çmimet për kapacitet sipas kufijve përkatës në përfundim të ankandit rezultuan të ndryshëm nga çmimet e përcaktuara në ankandin vjetor të zhvilluar nga OST, duke vendosur subjektet e përcaktuara në Vendimin 114, datë 22.08.2012, (Furnizuesit e Kualifikuar) në kushtet e pabarazisë me pjesëtarët e tjerë të tregut që ju alokuan kapacitet sipas ankandit të zhvilluar nga OST për muajin shtator 2012.

Vendimi 114, datë 22.08.2012 reflektonte parimin e barazisë në alokimin e kapaciteteve dhe pagesës përkatëse ndërmjet pjesëtareve të tregut

Rregullat e Alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të miratuara nga ERE me Vendimin nr.13 datë 22.02.2011, përcaktojnë se llogaritja e çmimit përfundimtar për kapacitet bazohet në renditjen e ofertave duke filluar nga çmimi më i lartë për të përfunduar me çmimin më të ulët.

Për sa më sipër, Bordi i Komisionerëve,

Vendosi:

1. Subjektet e përcaktuara sipas detyrimeve në pikën 3 të Vendimit nr. 114, datë 22.08.2012, do të paguajnë OST për kapacitetet e interkonjeksionit, sipas rezultateve dhe drejtimit të përcaktuara në ankandin të zhvilluar me datë 29.08.2012, nga OST, për muajin Shtator 2012
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë për këtë vendim të Bordit të Komisionerëve, shoqëritë OST sh.a, GSA sh.p.k, dhe “Rudnap Energy Tirana” shpk që preken nga ky vendim

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.